Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/495
Datë: 27.11.2020

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2020 nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Akreditohet QPAP "Oxford Studio" edhe me 2 degë të tjera, me lokacion në Fushë Kosovë, me adresë "Dardania" p.n. dhe në Mitrovicë me adresë "Kemajl Ataturk", për periudhë tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 28.10.2020 deri 28.10.2023, me kualifikimin:

1. **Gjuhë Angleze**, Dega në **Fushë Kosovë** - gjatë një jave mund të mbahet mësim me jo më shumë se 40 grupe, që i bie se secili mësimdhënës (4) mund të ketë deri në 10 grupe në javë. Ndërsa, numri i nxënësve për grup është deri në 15.
2. **Gjuhë Angleze**, Dega në **Mitrovicë** - gjatë një jave mund të mbahet mësim me jo më shumë se 20 grupe, që i bie se secili mësimdhënës (2) mund të ketë deri në 10 grupe në javë. Ndërsa, numri i nxënësve për grup është deri në 15.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së QPAP "Oxford Studio" për riakreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi rivalidimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve për Riakreditim të institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe

lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. QPAP "Oxford Studio";
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK